Nr.44/2024

Datë: 02/07/2024

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, duke u bazuar në dispozitat e nenit 5 paragrafit 6 dhe nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror si dhe dispozitat e nenit 53 dhe 55 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, merr këtë:

## VENDIM
### Për shfuqizim të Pëlqimit

1. **SHFUQIZOHET** Pëlqimi i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror i lëshuar me numër protokolli 0284 i datës 12.05.2022 për dhënie të pëlqimit për qasje në rrugën lidhëse L6-Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës me rrugën magjistrale M9, i lëshuar për kompaninë D.SH.Auto Servis "ENDRITI".

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### ARSYETIM

Me pëlqimin me numër protokolli 0284 të datës 12.05.2022, biznesit D.SH. Auto Servis "ENDRITI" (për parcelën me numër 00887-2, Zona Kadastrale Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë), i është dhënë qasje për kyçje në rrugën lidhëse L6, rrugë në pronësi të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës Sh.A., që lidhë Aeroportin me magjistralen M9.

Bazuar në dispozitat e LPPA-së është konstatuar se pëlqimi i lartcekur është lëshuar për pronën e subjektit tjetër juridik - Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës Sh.A., për të cilin ASHNA nuk ka pasur kompetencë dhe juridiksion.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të neneve 52, 53 dhe 55 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Samir BLLACAKU

Drejtor i ASHNA-së

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Vendimi i dërgohet:**

- *Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;*
- *Komunës së Fushë Kosovës;*
- *Palës- D.SH. Auto Servis "ENDRITI";*
- *Arkivit-ASHNA.*